

LIGJ
Nr. 88/2014

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 125/2013, “PËR KONCESIONET
DHE PARTNERITETIN PUBLIK PRIVAT”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në nenin 4, pika 1, pas shkronjës “ll” shtohet shkronja “m” me këtë përmbajtje:
“m) ndriçimi publik në territorin e njësive administrative vendore.”

Neni 2

Në nenin 5, pika 1, pas shkronjës “i” shtohet shkronja “j” me këtë përmbajtje:
“j) për koncesionet e punëve publike për ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e rrugëve nacionale, kur ato paraqesin rëndësi të veçantë për infrastrukturën rrugore të vendit.”

Neni 3

Në nenin 19, pika 4 hiqet.

Neni 4

Në nenin 29, në fund të pikës 1 shtohet një fjali me këtë përmbajtje:
“Përjashtimi nga pagesa e kësaj tarife bëhet vetëm për rastet e koncesioneve që aplikohen në fushën e shëndetësisë.”

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 17.7.2014

Shpallur me dekretin nr. 8669, datë 1.8.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani